

MONITORIMI I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

**SHTATOR – DHJETOR 2016
RAPORTI I DYTË VJETOR**



ISP
INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
REALIZUAR NGA

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

MBI INSTITUTIN E STUDIMEVE POLITIKE - ISP



PËRMBAJTJA

1. Hyrje

2. Metodologjia

3. GJETJET KRYESORE

4. TË DHËNAT PËR SEANCAT PLENARE

- a. *Seancat plenare gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016*
- b. *Seancat plenare gjatë vitit 2016*
- c. *Deputetët më me shumë diskutime*
- d. *Deputetët “e heshtur”*
- e. *Problematikat kryesore për seancat plenare*

5. KOMISIONET PARLAMENTARE

- a. *Komisionet parlamentare, - gjetjet kryesore*
- b. *Aktiviteti i Komisioneve të posaçme parlamentare*
- c. *Aktiviteti i Komisioneve të përhershme parlamentare*
 - i. *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*
 - ii. *Komisioni i Sigurisë Kombëtare*
 - iii. *Komisioni i Integritimit Evropian*
 - iv. *Komisioni i Politikës së Jashtme*
 - v. *Komisioni për Financë dhe Ekonomi*
 - vi. *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*
 - vii. *Komisioni i Punës, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë*
 - viii. *Komisioni për Edukimin dhe mjetet e Informimit Publik*

6. REKOMANDIME

EKIPI REALIZUES

Drejtues i monitorimit: Afrim Krasniqi

Grupi monitoruese: Iris Shima, Adela Xhafa, Brunilda Brati, Rigels Xhemollari

I. HYRJE

Në sistemin tonë politik institucioni i parlamentit (Kuvendi i Shqipërisë) ka rol themelor në përfaqësimin e vullnetit qytetar, në vendimmarrje dhe në procesin legjislativ. Parlamenti aktual është zgjedhur në qershor 2013 dhe mandati i tij përfundon me zgjedhjet periodike në qershor 2017. Ky parlament përfaqëson një prej katër rasteve të rotacionit politik (1992, 1997, 2005 dhe 2013), është ndër të vetmit me legjitimitet të plotë (pa bojkotim politik pas-zgjedhor) dhe mbyll çerek shekullin e parë të tranzicionit.

Për shkak të rotacionit politik, votimit masiv kundër mazhorancës arrogante politike të para vitit 2013, si dhe nevojave të mëdha të vendit për reforma e ndryshime, parlamenti i vitit 2013-2017 kishte pritshmëri të larta politike, qytetare dhe institucionale. Mazhoranca e re parlamentare ishte në shumicë absolute përfaqësues e një elite të re politike, pjesa tjetër trashëgohej nga mazhoranca e mëparshme politike. LSI dhe PDIU, dy parti të rëndësishme dhe përcaktuese për mazhorancën, midis 2009-2013 ishin pjesë e koalicionit të djathtë politik.

Në kuadrin e ri politik dhe kushtetues parlamenti aktual, përveç pritshmërive të larta publike, kishte edhe votëbesimin e nevojshëm për reformim të thellë të sistemit përfaqësues, për një sjellje të re politike, raport të ri midis qytetarit dhe politikës, për më shumë transparencë dhe përfshirë, për partneritet aktiv dhe rezultate më cilësore. Pas katër vitesh, shumica e këtyre pritshmërive nuk janë përmbushur. Parlamenti aktual, në tërësinë e tij dështoi të ishte institucion reformator dhe frymëzues për ndryshim, besimi publik tek parlamenti ra në kuotat minimale historike, problematika e de-kriminalizimit dhe identifikimi i një numri parlamentarësh me të ndikoi dukshëm në kompromentimin e rolit të tij në sistemin politik dhe në funksionin përfaqësues.

Institucioni i Studimeve Politike inicioi në korrik 2016 monitorimin vullnetar të jetës parlamentare: aktiviteti i tij, roli i deputetëve, produkti parlamentar, angazhimi në séance dhe në ligjvënien, etj. Raporti shërbeu si bazë e mirë për vijimin e monitorimit përmes një metodike më të zgjeruar dhe më profesionale përgjatë sesionit të vjeshtës shtator-dhjetor 2016. Ky është raporti i dytë monitorues i Institutit të Studimeve Politike.

Gjatë vitit 2017 Instituti i Studimeve Politike do të vijojë monitorimin aktiv të jetës parlamentare me mbështetje të konfirmuar nga fondacioni gjerman Fridrich Ebert, si dhe nga partnerë të tjerë të mundshëm përëndimorë në Tiranë. Ekipi i ISP do të bashkëpunojnë ngushtësisht me stafin parlamentar, me grupet parlamentare, me komisionet për një monitorim aktiv, solid, cilësor, integral dhe sa më përfaqësues. Në këtë mënyrë, Instituti i Studimeve Politike bëhet organizata e vetme në Shqipëri që ka fokus të saj monitorimin e parlamentit, funksioneve, aktivitetit dhe produktit të tij, - një mision sa profesional, aq edhe me interes të madh publik.

Gjetjet e raportit janë një përgjigje për interesin e madh publik për jetën parlamentare, por edhe për cilësinë e përfaqësimit politik në vend. Ato ndihmojnë publikun dhe vetë parlamentin, ndihmojnë partitë politike të përfaqësuara, median dhe grupet e tjera të interesit të lidhura me parlamentin.

Si theksohet edhe në vetë-prezantimin e Kuvendit “të gjithë anëtarët e Parlamentit kanë përgjegjësinë të përfaqësojnë opinionin e zgjedhësve të tyre gjatë debateve të ndryshme parlamentare në mënyrë të tillë që të shprehin, sa të jetë e mundur, çfarë kërkon shumica e zgjedhësve, që përfaqësohet nga mazhoranca parlamentare“. Raporti monitorues i ISP përpiqet ti japë përgjigje kësaj sfide dhe të dëshmojë përmes të dhënave sasiore dhe cilësore nivelin e përmbushjes së kësaj përgjegjësie nga parlamenti dhe deputetët.

2. METODOLOGJIA

Monitorimi bazohet në aspekte të ndryshme vlerësimi dhe angazhimi, përmes një procesi monitorues të detajuar. Monitorimi do të jetë aktiv dhe i trefishtë: monitorim aktiv e krahasues' rekomandime për përmirësime, si dhe analizë e publikim profesional i të dhënave cilësore.

Baza e të dhënave janë diskutimet në seancat plenare dhe në komisionet parlamentare, niveli i transparencës së Parlamentit në publikimet online, të dhënat cilësore të marra nga aktiviteti parlamentar, si dhe të dhëna të marra nga kontaktet direkte me deputetë/grupe parlamentare lidhur me problematika të veçanta të punës së tyre.

Në fazën e ardhshme të monitorimit synohet krijimi i një aplikacioni online, përmes të cilit çdo zgjedhës do të njihet në kohë për aktivitetin e deputetit të zonës/qarkut zgjedhor, si dhe aktiviteti parlamentar publik e jo publik do të jetë në dispozicion, në zbatim të standardeve të larta të transparencës dhe të mirëqeverisjes, standarde që përbëjnë detyrim për një demokraci të zhvilluar, detyrim për një vend kandidat për në Bashkimin Evropian dhe parim kushtetues për Shqipërinë.



3. GJETJET KRYESORE

Institucioni i Kuvendit wshtw institucioni kryesor i zhvillimit tw politikws, por njwherwsh, institucioni mw pak i monitoruar nga shoqëria civile, media dhe aktorw tw tjerw institucionalw. Rendja pas debateve politike dhe vendimeve nw seancat plenare ka lwnw nw hije nevojën e madhe tw konceptit tw “parlamentit tw hapur” ndaj qytetarwve votues dhe publikut tw gjerw.

- Kuvendi ka rritur nivelin e transparencës publike pwrmes publikimit tw akteve kryesore (mbledhjet, seancat, njoftimet e aktivitetit, votimet, aktet nw shqyrtim, etj). Ky zhvillim pwrbyn risi nw raport me tw kaluarwn. Megjithatë nw aspekte tw tjera, si transparenca financiare dhe administrative ende nuk ka progres, dhe se niveli i transparencës nw twrwsi, mbetet ende larg modelet bashkëkohore parlamentare.
- Aktiviteti parlamentar ka njw bilanc pune simbolik nw krahasim me pritshmritw publike dhe nevojat e vendit pwr axhendw reformash. Numri minimal i ligjeve tw miratuara tregon se deputetw nuk e kanw konsumuar tw drejtwn e tyre tw inicimit tw ligjeve dhe se qeveria nuk ka arritur tw “ushqejw” Kuvendit me nisma ligjore dhe akte tw tjera.
- Aktiviteti kryesor parlamentar bazohet nw seancat parlamentare dhe debatet politike. Roli i komisioneve, megjithëse nw rritje, ende mbetet periferik dhe pa ndikim thelbësor nw axhendwn parlamentare. Seancat tërheqin tw gjithw kapacitetet parlamentare dhe pwrbwjnw pikwn kryesore lidhëse midis deputetwve dhe zgjedhësve tw tyre.
- Edhe nw kwtw sesion parlamentar retorikat dominuese nw seancat plenare ishin fjalimet dhe replikat midis kryeministrit dhe ish kryeministrit. Nw përqindje ata zwnw pjesën mw tw rwndwsishme tw debatit parlamentar politik (rreth 30-35%), njw rast ky unikal nw praktikat parlamentare tw sotme.
- Deputetw mw me shumw diskutime parlamentare nw seancat plenare rezultojnë edhe deputetw mw me pak kontribute nw punwn e komisioneve parlamentare. Ky wshtw tregues se aktiviteti nw seanca lidhet me impaktin publik dhe se roli i deputetwve, nga ligjvwnws, wshtw zhvendosur nw oratori politike.
- Nw kundërshtim me rregulloren e Kuvendit, ka deputetw qw nuk janw regjistruar si anwtarw nw Komisionet e përhershme parlamentare, si dhe ka deputetw qw kanw munguar nw tw gjitha mbledhjet e komisioneve tw përhershme parlamentare. Nw secilin rast strukturat drejtuese tw Kuvendit nuk kanw ndjekur dhe as përmbushur praktikat e përcaktuara nw rregullore.
- Tw dhënat mbi CV e deputetwve janw tw paplota, tw pasakta, pa standard tw njwjt w prezantimi dhe pamundwsojnw transparencën publike tw aktivitetit tw tyre jetësor profesional dhe politik.
- Programi online “kontakto deputetin twnd”, me gjithw risinw e tij, nuk wshtw funksional, nuk ka përfshirje tw deputetwve dhe as tw komunikimit tw tyre me zgjedhësit.
- Njw swrw elementwsh tw transparencës, sic janw programi E-parlamenti, E-demokracia, etj, janw ende nw ndërtim, pa informacion dhe funksion praktik.
-

4. TË DHËNAT PËR SEANCAT PLENARE


Seancat plenare janë aktiviteti më i rëndësishëm parlamentar, pasi janë aktivitetet i dyfishtë: debat politik dhe vendimmarrje ligjore. Çdo vendim në seancë merret me votë dhe fiton legjitimitet, ndaj edhe seancat janë tradicionalisht një herë në javë: ditët e enjte. Të dhënat e mëposhtme tregojnë ecurinë e seancave gjatë sesionit të vjeshtës 2016, por ka tabela ilustruese edhe për periudhën e dy sesioneve, pra gjatë gjithë vitit 2016.

3.1 SEANCAT PLENARE GJATË PERIUDHËS SHTATOR-DHJETOR 2016

Gjatë sesionit të parë 2016 parlamenti miratoi 145 akte, rreth 41 më shumë sesa gjatë sesionit të vjeshtës 2016. Konkretisht, gjatë katër muajve të punës në sesionin e dytë parlamentar (shtator-dhjetor 2016), Kuvendi ka miratuar 104 akte, nga të cilat, vetëm 22 janë ligje të reja. Ditët rekord të ligjeve në parlament mbeten 10 dhe 27 tetori, gjatë të cilave u miratuan katër ligje pjesë të paketës së reformës në drejtësi.

Më shumë akte parlamentare janë miratuar ditën e fundit të punimeve të Kuvendit, më 22 dhjetor, rreth 17 akte, - një tregues se deputetët nxitonin për pushimet e fundvitit dhe mbylljen e sesionit, ndaj edhe treguan vullnet votimi në “sasi” të akteve ligjore, në kontrast të thellë me seancën e parë të shtatorit 2016, kur deputetët votuan vetëm 1 akt parlamentar. Me të njëjtën logjikë, megjithëse në dhjetor 2016 u zhvilluan vetëm 3 seanca parlamentare, nga 4 seanca në tetor e nëntor dhe 5 seanca në shtator 2016, në dhjetor janë miratuar shumë më tepër akte parlamentare sesa në secilin nga muajt e tjerë.

Numri i akteve është tregues i punës sasiore të Kuvendit, kurse brendësia e tyre është çështje e cilësisë së akteve dhe cilësisë së aktivitetit të deputetëve/Kuvendit. Referuar të dhënave cilësore të akteve, rezulton se numri më i madh i akteve është i natyrës procedurale (rend dite - axhendë, ndryshim në komisione, ndryshim në afate pune, etj). Konkretisht kjo kategori procedurale zë 32% ose një të tretën e totalit të akteve.



Amendimet e ligjeve të ndryshme zënë kategorinë e dytë të akteve, me 26% të totalit. Rreth një e pesta e akteve parlamentare janë ligje (21%). Rezolutat e Kuvendit zënë vetëm 1% të akteve, kurse procedurat zgjedhore (zgjedhjet në KQZ, në Bordin për hapjen e dosjeve, etj), si dhe ratifikimet e marrëveshjeve të ndryshme zënë përkatësisht 9-10% të akteve të parlamentit. Në total kemi 2 rezoluta, 10 procese

zgjedhore në parlament dhe 10 ratifikime, 22 ligje, 27 amendime ligjore dhe 33 praktika procedurale vendimmarrëse.

Sesioni i dytë (shtator – nëntor 2016) zë katër muaj, 17 javë dhe rreth 130 ditë. Në shifra krahasimore rezulton se parlamenti çdo 5-6 ditë ka miratuar një ligj, çdo 4-5 ditë ka bërë një amendim ligjor dhe çdo 65 ditë ka miratuar një rezolutë. Referuar praktikës shqiptare shifrat nuk janë shumë alarmante, por referuar praktikës së vendeve të tjera më të suksesshme në jetën institucione e demokratike shifrat janë dukshëm alarmante. Llogaria është e thjeshtë: 140 deputetë dhe 20 ministra kanë arritur të prodhojnë vetëm 1 ligj në 5-6 ditë, (në javë, përfshirë të dielën).

Statistika nuk tregon vetëm varfërinë në praktikën e hartimit të ligjeve dhe në nismat për reforma ligjore serioze, por edhe koston e lartë që taksapaguesit përballojnë për deputetë e ministra, të cilët kanë pasur bilanc kaq minimal të propozimit dhe miratimit të ligjeve të reja.

Numri i lartë i amendimeve ligjore është tregues i brishtësisë së ligjeve në vite dhe praktikës së “arnimit” të ligjeve, kryesisht për shkak të kontrastit midis ligjeve dhe zbatimit të tyre praktik, ose për shkak të interesave politike ose klienteliste afatshkurtra për të përfituar përmes amendimeve ligjore. Kjo tezë kritike përforcohet nisur edhe nga fakti se amendimet ligjore janë kryesisht në fushën e taksave, financave, etj, dhe se çështjet më të debatueshme parlamentare ishin e mbeten edhe për janarin 2017, çështja e importit të mbetjeve dhe taksave për kazinotë.

3.2. DEPUTETËT MË ME SHUMË DISKUTIME NË SEANCA

Në monitorimin e Kuvendit nga Instituti i Studimeve Politike rezulton se gjatë 16 seancave parlamentare të sesionit të vjeshtës (shtator – dhjetor 2016) dominues në fjalime janë politikanët kryesorë të partive politike. Ndryshe nga sesioni i pranverës gjatë të cilit ish kryeministri Berisha kishte shumë më tepër diskutime sesa kryeministri aktual Rama, në sesionin e vjeshtës kryeministri Rama është dominues me diskutim në 14 seanca parlamentare ose në 88% të seancave. Pas tij në vendin e dytë është Berisha me 13 seanca ose 81%, ndjekur nga Asllan Dogjani dhe Astrit Patozi me nga 12 fjalime/ndërrhyrje ose 75%.

AKTET E MIRATUARA NË KUVEND GJATË PERIUdhËS SHTATOR-DHJETOR 2016							
SEANCA	LIGJE	AMENDIME	RATIFIKIME	PRODECURE	ZGJEDHJE	REZOLUTA	TOTAL
05.09.2016	-	-	-	1	-	-	1
08.09.2016	1	1	1	3	-	-	6
15.09.2016	1	2	1	2	-	-	6
22.09.2016	1	1	-	3	-	-	5
29.09.2016	-	1	1	-	-	-	2
06.10.2016	4	1	-	1	-	-	6
13.10.2016	-	-	-	1	-	-	1
20.10.2016	2	2	1	4	-	1	10
27.10.2016	4	2	-	1	-	-	7
03.11.2016	1	4	-	4	1	-	10
10.11.2016	1	-	2	1	1	-	5
17.11.2016	-	-	-	-	6	-	6
24.11.2016	2	1	-	3	-	-	6
01.12.2016	1	4	-	-	-	-	5
15.12.2016	-	3	1	4	2	1	11
22.12.2016	4	5	3	5	-	-	17
Total	22	27	10	33	10	2	104

Në vendin e pestë është Ben Blushi, drejtuesi i LIBRA me 11 fjalime ose 69%, pasuar nga Jozefina Topalli me 10 fjalime. Deputeti socialist Erion Brace është i dyti nga PS në listën e 8 emrave më me shumë diskutime, me 9 fjalime ose 56%, aq sa kolegu i tij Taulant Balla, si dhe dy deputetët e PD Jorida Tabaku dhe Myqerem Tafaj. Më pas me nga 8 fjalime janë katër deputetët: Vokshi e Boci (PD), Bushati (PS) dhe Hafizi (LIBRA). Në listën e 20 deputetëve më me shumë fjalime gjatë sesionit të dytë parlamentar 2016 bëjnë pjesë edhe pesë deputetë të PD (Bode, Bumci, Çupi, Hajdarmata, Noka) si dhe Doda (PDIU).

DEPUTETET MË ME SHUMË DISKUTIME GJATË SESIONIT SHTATOR-DHJETOR 2016

EDI RAMA	PS	14	88%	ALBANA VOKSHI	PD	8	50%
SALI BERISHA	PD	13	81%	LUCIANO BOCI	PD	8	50%
ASLLAN DOGJANI	PD	12	75%	ERVIN BUSHATI	PS	8	50%
ASTRIT PATOZI	PD	12	75%	MIMOZA HAFIZI	LIBRA	8	50%
BEN BLUSHI	LIBRA	11	69%	ALDO BUMCI	PD	7	44%
JOZEFINA TOPALLI	PD	10	63%	MESILA DODA	PDIU	7	44%
ERION BRACE	PS	9	56%	RIDVAN BODE	PD	7	44%
JORIDA TABAKU	PD	9	56%	DHURATA CUPI	PD	7	44%
MYQEREM TAFAJ	PD	9	56%	FLAMUR NOKA	PD	7	44%
TAULANT BALLA	PS	9	56%	MIMOZA HAJDARMATA	PD	7	44%

Monitorimi i Kuvendit: shtator-dhjetor 2016. Realizuar nga Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al)

INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES

www.isp.com.al

Siç shihet nga tabela, në 20 deputetët më me shumë fjalime PS ka vetëm 4 deputetë, PDIU ka 1 deputet, LIBRA ka 2 deputetë dhe PD shifër rekord me 13 deputetë. Në terma teknike të debatit parlamentar duket se opozita ka qenë të paktën 3 herë më aktive në debate parlamentare sesa mazhoranca, por në terma politike dhe sasiorë përfundimet janë të tjera. Nga PS janë angazhuar disa prej ministrave kryesorë në gjysmën e seancave, dhe se një pjesë e diskutimeve të ardhura nga deputetët e opozitës kanë qenë replika, fjalime moment ose ndërhyrje me problematika teknike, - gjë që flet për bilanc të balancuar përfaqësimi.

Nga kontaktet me deputetët e karrierës në partitë politike, të cilët nuk janë pjesë e kësaj liste prej 20 deputetësh, mosangazhimi i tyre i rregullt në fjalime shpjegohet me faktin se shumica e tyre janë detyruar nga kryesia e grupit parlamentar të japin dorëheqje nga fjalimet, për shkak të situatës që krijohet në replikat e vazhdueshme midis kryeministrit dhe ish kryeministrit. Ky argument jepet nga dy palët kryesore politike, çfarë tregon se séance e të enjtes në parlament mbetet dominuese nga fjalimet dhe replikat midis kryeministrit dhe ish kryeministrit, dhe se drejtimi i fjalës së tyre përcakton

de facto edhe ecurinë e debatit dhe bilancin e punës së parlamentit në funksionin e tij kushtetues si përfaqësues i shtetësimin dhe interesave të qytetarëve.

Tabela e dytë paraqet diskutimet e deputetëve nga 1 në 6 fjalime, pra me prani dhe aktivitet gati simbolik në parlament. Aty bëjnë pjesë figura të njohura të politikës nga secila nga partitë politike. Interesant është fakti se edhe kryetarët e grupeve parlamentare, në përgjithësi kanë shumë pak fjalime parlamentare, dhe se e njëjta vlen edhe për kryetarin e nënkryetarët e Kuvendit, të cilat për shkak të rolit teknik në moderimin e seancave nuk mund të llogariten si deputet aktiv në debat.

Siç shihet nga tabela, vetëm 2 nga 20 deputetët më me shumë fjalime janë edhe kryetarë të komisioneve të përhershme parlamentare, pra jo të gjithë drejtuesit e komisioneve janë po kaq aktiv në debatet politike dhe legjislative në parlament, - një bilanc kritik për aftësinë e tyre drejtuese.

NUMRI I DISKUTIMEVE TE DEPUTETEVE TE TJERE NE KUVEND (SESIONI I DYTE) 2016								
Albina Deda	6	38%	Majlinda Bregu	4	25%	Omer Mamo	2	13%
Eduart Shalsi	6	38%	Petrit Vasili	4	25%	Rakip Suli	2	13%
Genc Pollo	6	38%	Pjerin Ndreu	4	25%	Robert Bitri	2	13%
Helidon Bushati	6	38%	Gerti Bogdani	4	25%	Roland Keta	2	13%
Vangjel Dule	6	38%	Silva Caka	4	25%	Spartak Braho	2	13%
Xhemal Qefalia	6	38%	Ulsi Manja	4	25%	Kejdi Mehmetaj	2	13%
Arben Cuko	5	31%	Vasilika Hysi	4	25%	Perparim Spahiu	2	13%
Arbjola Halimi	5	31%	Alfred Peza	3	19%	Adelina Rista	1	6%
Artan Gaci	5	31%	Bedri Hoxha	3	19%	Alban Zeneli	1	6%
Besnik Baraj	5	31%	Blerina Gjylameti	3	19%	Andrea Marto	1	6%
Ervin Koci	5	31%	Edlira Cekrezi	3	19%	Aqif Rakipi	1	6%
Gjergji Papa	5	31%	Evis Kushi	3	19%	Arben Imami	1	6%
Igli Cara	5	31%	Fatmir Mediu	3	19%	Bujar Cela	1	6%
Irma Kopliku	5	31%	Fatmir Xhafa	3	19%	Dashamir Shehi	1	6%
Namik Kopliku	5	31%	Luan Rama	3	19%	Dashamir Tahiri	1	6%
Agron Duka	5	31%	Paulin Sterkaj	3	19%	Esmeralda Shkja	1	6%
Gledion Rehovica	5	31%	Eduart Halimi	3	19%	Gjovalin Bzhetaj	1	6%
Oerd Bylykbashi	5	31%	Piro Lutaj	3	19%	Gjovalin Kadeli	1	6%
Anastas Angjeli	4	25%	Anila Agalliu	2	13%	Ilirjan Pendavinji	1	6%
Antoneta Dhima	4	25%	Arta Dade	2	13%	Pandeli Maiko	1	6%
Arben Ristani	4	25%	Edmond Leka	2	13%	Piro Kapurani	1	6%
Eleina Qirici	4	25%	Eduart Beiko	2	13%	Sadri Abazi	1	6%
Florion Mima	4	25%	Erieta Alhysa	2	13%	Tahir Muhedini	1	6%
Kastriot Islami	4	25%	Gent Strazimiri	2	13%	Verxhi Mucmataj	1	6%
Klodiana Spahiu	4	25%	Gentian Bejko	2	13%	Bedri Mihaj	1	6%
Kozma Dashi	4	25%	Keltis Kruja	2	13%	Musa Ulqini	1	6%
Liliana Elmazi	4	25%	Olta Xhacka	2	13%	Nard Ndoka	1	6%
<i>Monitorimi i Kuvendit: shtator-dhjetor 2016. Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al)</i>								

Gjithashtu me domethënie është fakti se deputetët më me shumë angazhime në fjalime parlamentare, në përgjithësi, kanë koeficient zero në angazhimet në debatet në komisionet parlamentare. Arsyeja?

Janë dy shpjegime: e para, disa prej tyre janë të aftë të bëjnë fjalime, por nuk janë të aftë të prodhojnë ligje. E dyta, seanca parlamentare ka shikueshmëri të lartë televizive dhe vëmendje maksimale nga publiku, ndaj investimi i tyre fokusohet këtu, kurse komisionet janë natyrë teknike dhe të mbyllur, ndaj prej tyre është e vështirë të prodhohen lajme në media.

Një krahasim i të dhënave të seancave plenare në dy sesionet parlamentare 2016, pra përgjatë një viti kalendarik, rezulton një renditje interesante e politikanëve më aktiv në debatet parlamentare: më 2016 dominues në fjalime parlamentare në seancat plenare ishte ish kryeministri Berisha me 31 fjalime, i ndjekur nga Ben Blushi me 26 fjalime. Me nga 24 fjalime kanë Taulant Balla dhe Jozefina Topalli. I pesti në renditje është kryeministri Rama, me 23 fjalime, ose 8 fjalime më pak sesa paraardhësi i tij Berisha, 3 fjalime më pak sesa kritiku më i ashpër i tij në PS, Ben Blushi, tashmë themelues i LIBRA.

EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	SESIONI I	SESIONI II	TOTAL 2016
SALI BERISHA	PD	18	13	31
BEN BLUSHI	LIBRA	15	11	26
JOZEFINA TOPALLI	PD	14	10	24
TAULANT BALLA	PS	15	9	24
EDI RAMA	PS	9	14	23
ASLLAN DOGJANI	PD	8	12	20
ERION BRACE	PS	11	9	20
ASTRIT PATOZI	PD	7	12	19
ERVIN BUSHATI	PS	11	8	19
ALBANA VOKSHI	PD	10	8	18
FLAMUR NOKA	PD	10	7	17
MIMOZA HAJDARMATA	PD	10	7	17
ALDO BUMCI	PD	9	7	16
GENC POLLO	PD	10	6	16
MESILA DODA	PDIU	9	7	16
LUCIANO BOCI	PD	7	8	15
OERD BYLYKBASHI	PD	10	5	15
MIMOZA HAFIZI	LIBRA	6	8	14
JORIDA TABAKU	PD	5	9	14
HELIDON BUSHATI	PD	7	6	13
MYQEREM TAFAJ	PD	4	9	13
RIDVAN BODE	PD	6	7	13

Monitorimi i Kuvendit: shtator-dhjetor 2016. INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE web: www.isp.com.al

Në listë vijojnë emra të njohur politik të partive kryesore: Brace, Patozi, Bushati, Vokshi, Noka, etj. Sic shihet, dominuese në listën e deputetëve më aktiv në parlament janë grupi parlamentar i PD. Nga

socialistët në këtë listë janë vetëm Rama, Balla, Brace, Bushati, kurse PD ka 15 emra. Midis më aktivëve janë edhe dy deputetët themelues të LIBRA, Blushi e Hafizi, si dhe Doda e PDIU.

3.3. DEPUTETËT “E HESHTUR” NË SEANCAT PARLAMENTARE

Shumë më interesante sesa lista e deputetëve aktivë, është edhe lista e deputetëve pasivë në seancat parlamentare. Pas publikimit të raportit kritik të sesionit të parë, në fillim të sesionit të dytë, disa prej deputetëve të cituar për 0 diskutime, nxituan të kërkojnë fjalën në séance debati, sidomos në minutazhin e debatit të lirë, për të hequr emrin nga lista e të “heshturve”. Kjo përpjekje, në prag të zgjedhjeve të reja parlamentare, është taktikë pozitive për deputetët që e praktikuan.

Gjithsesi, edhe në këtë sesion pati një numër të lartë deputetësh që nuk u angazhuan në asnjë nga seancat parlamentare. Konkretisht, tabela përmban edhe 32 deputetët që nuk kanë folur në asnjë nga seancat parlamentare të sesionit të vjeshtës (shtator-dhjetor 2016). Me përjashtim të ndonjë deputeti me probleme shëndetësore (BF) apo që ka pasur fatkeqësi familjare apo që është në proces gjykimi gjyqësor, lista e të heshturve paraqet një kontrast të thellë: ka midis tyre figura politike me përvojë të gjatë dhe me njohje të gjerë publike, (Dokle, Ruli, Cani, Selami, Tavo, Kryemadhi, Toçi, Shkreli, etj), dhe ka deputetë të cilët mbeten anonim ende për publikun dhe bilanc formal përfaqësimi (Duzha, Shehu, Troplini, Derveni, Xhindi, Çela, Ferracaku, Prenga, Xhakolli, etj).

Disa prej këtyre deputetëve, sidomos politikanët me përvojë parlamentare, e justifikojnë heshtjen me tri argumente:

- E para, një pjesë e tyre kanë qenë aktiv në mbledhjet e komisioneve parlamentare “jashtë kamerave” televizive, dhe ndaj mendojnë se nuk kanë fokus apo qëllim të tyre daljen përpara kamerave televizive me fjalime rutinë vetëm për të qenë “politikisht korrekt”.

- E dyta, shumë prej tyre bëjnë pjesë në grupet kritike brenda partive të tyre politike, dhe ndaj,

DEPUTETET QË KANË “HESHTUR” GJATË SESIONIT SHTATOR-DHJETOR 2016					
01. ARMANDO PRENGA	0	PS		17. LUAN DUZHA	0 LSI
02. ANDUEL XHINDI	0	PS		18. LULJETA ARAPI	0 PS
03. AGRON ÇELA	0	LSI		19. MHILL FUFİ	0 PD
04. ASTRIT VELIAJ	0	PD		20. MIRA SHEHU	0 PS
05. BASHKIM FINO	0	PS		21. MIRELA FERRACAKU	0 PKD
06. BUJAR DERVENI	0	PS		22. MONIKA KRYEMADHI	0 LSI
07. BUJAR KLOGJRI	0	LSI		23. NAMIK DOKLE	0 PS
08. DASHAMIR KAMBERI	0	PS		24. PARİD CARA	0 PS
09. DASHAMIR PEZA	0	PS		25. SHKELQIM CANI	0 PS
10. EDUART SELAMI	0	PD		26. SHKELQIM SELAMI	0 LSI
11. EDUART NDOCAJ	0	PS		27. SHKELQIM TROPLINI	0 PS
12. ENKELEJDA SHKRELI	0	PS		28. TOM DOSHI	0 PS
13. FATMİR TOÇI	0	PS		29. VANGJEL TAVO	0 LSI
14. FİDEL YLLI	0	PS		30. VLADİMİR KOSTA	0 PS
15. GENÇ RULI	0	PD		31. YLLI SHEHU	0 LSI
16. ILİR XHAKOLLI	0	PS		32. YLLI ZIÇISHTI	0 PS

Monitorimi i Kuvendit: shtator-dhjetor 2016. Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al)

ndjehen nën presionin e brendshëm partiak për të folur sipas vijës zyrtare ose për të përdorur auto-censurën në rastin e mendimeve kritike.

- E treta, një pjesë e tyre kanë shënuar emrin në sekretaritë e parlamentit për të diskutuar në seanca, por në momentin e fundit, për shkak të rrjedhave jo normale në seanca, kërret e grupeve parlamentare kanë ndryshuar listën e diskutuesve, duke përzgjedhur më të preferuarit e tyre.

Gjithsesi, pavarësisht tri argumenteve të tyre, tabela mbetet një bilanc kritik dhe një kampion alarmi për aktivitetin parlamentar të individëve në tabelë dhe të partive respektive parlamentare, - vetëm gjashtë muaj përpara zgjedhjeve të reja parlamentare.

Tabela e të heshturve bëhet edhe më interesante me dy kategori të tjera të “heshturish”, ata në seancat plenare përgjatë një viti (pra edhe gjatë sesionit të pranverës në parlament), si edhe ata që kanë heshtur edhe në debatet e shumta në komisionet parlamentare.

Tabela më poshtë jep listën e deputetëve që nuk kanë folur fare në seancat parlamentare përgjatë një viti. Në listë bën pjesë vetëm një deputet nga PD, gjashtë nga LSI dhe pjesa tjetër nga grupi parlamentar i PS. Shumica e këtyre të fundit janë prurje të reja “të fortësh” më 2013, kryesisht biznesmenë të periferisë ose individë pa karrierë politike normale në parti.

EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	SESIONI I	SESIONI II	TOTAL 2016
<u>Agron Cela</u>	LSI	0	0	0
<u>Bujar Derveni</u>	LSI	0	0	0
<u>Monika Kryemadhi</u>	LSI	0	0	0
<u>Shkelqim Selami</u>	LSI	0	0	0
<u>Vangjel Tavo</u>	LSI	0	0	0
<u>Ylli Shehu</u>	LSI	0	0	0
<u>Mhill Fufi</u>	PA PARTI	0	0	0
<u>Astrit Veliaj</u>	PD	0	0	0
<u>Anduel Xhindi</u>	PS	0	0	0
<u>Armando Prenga</u>	PS	0	0	0
<u>Bashkim Fino</u>	PS	0	0	0
<u>Dashamir Kamberi</u>	PS	0	0	0
<u>Dashamir Peza</u>	PS	0	0	0
<u>Enkelejda Shkreli</u>	PS	0	0	0
<u>Fidel Ylli</u>	PS	0	0	0
<u>Ilir Xhakolli</u>	PS	0	0	0
<u>Luljeta Arapi</u>	PS	0	0	0
<u>Namik Dokle</u>	PS	0	0	0
<u>Parid Cara</u>	PS	0	0	0
<u>Shkelqim Troplini</u>	PS	0	0	0
<u>Tom Doshi</u>	PS	0	0	0
<u>Vladimir Kosta</u>	PS	0	0	0

Monitorimi i Kuvendit: shtator-dhjetor 2016. INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE web: www.isp.com.al

Në vlerësimin e angazhimit të deputetëve në komisionet parlamentare, duhet thënë se kryetarët e komisioneve kanë qenë mjaft aktivë dhe kanë përqindje maksimale angazhimi. Edhe në rastet kur përqindja nuk është 100% do të thotë se nuk kanë qenë të pranishëm në seancë. Tabela tregon numrin e deputetëve të angazhuar nëpër komisione pa qenë kryetar komisioni.

Siç shihet në krye të listës qëndron “kryetari” de facto i komisionit parlamentar të medias dhe kulturës, Alfred Peza, i cili edhe pse është zv/kryetar, duke qenë përfaqësues i mazhorancës ka rol specifik në komision.

EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	DISK. KOMISION	EMRI DHE MBIEMRI	PARTIA	DISK. KOMISION
ALFRED PEZA	PS	100%	ERVIN KOÇI	PS	57%
ARBJOLA HALIMI	PD	79%	RIDVAN BODE	PD	57%
FATMIR TOÇI	PS	78%	ADELINA RISTA	PS	56%
MYQEREM TAFAJ	PD	78%	GJERGJI PAPA	PD	52%
ASLLAN DOGJANI	PD	75%	ALBINA DEDA	PD	50%
DHURATA ÇUPI	PD	75%	ALDO BUMÇI	PD	50%
FLAMUR NOKA	PD	75%	BEDRI MIHAJ	PD	50%
PIRO LUTAJ	PS	75%	ERJETA ALHYSA	PS	50%
NAMIK KOPLIKU	PS	70%	KASTRIOT ISLAMI	PD	50%
VASILIKA HYSI	PS	70%	PJERIN NDREU	PS	50%
GENC RULI	PD	67%	ROLAND KETA	PD	50%
LUÇIANO BOÇI	PD	67%	HELIDON BUSHATI	PD	48%
KLODIANA SPAHIU	PS	64%	FLORION MIMA	PD	48%
KOZMA DASHI	PD	59%	ASTRIT VELIAJ	PD	44%
BEDRI HOXHA	PD	57%	BUJAR KLLOGJRI	LSI	44%
BESNIK BARAJ	PS	57%	FIDEL YLLI	PS	44%

Shënim: Nga tabela janë përjashtuar kryetarët e komisioneve Xhafaj, Dade, Braho, Brace, Shalsi, Vakshi, Bregu, Pollo, të cilët duke qenë drejtues kanë tregues 100% të pjesëmarrjes në debatet në Komisione

Në vendin e dytë më me shumë angazhime është deputetja e PD Halimi, shumë më tepër aktive sesa politikanë të njohur të karrierës parlamentare. Më pas vijojnë pafaj, Dogjani, Cupi e Noka të PD, ndjekur nga Lutaj, Kopliku e Hysi të PS-së, Ruli e Boci të PD, Spahiu e PS, etj. Në këtë listë të angazhimeve bëjnë pjesë edhe deputetë, të cilët nuk kanë përvojë të njëjtë angazhimi në seancat plenare, siç janë Veliaj (PD), Ylli (PS), Kllogjri (LSI), etj.

Tabela tjetër paraqet deputetët që nuk kanë folur në komisionet e përhershme parlamentare gjatë sesionit shtator-dhjetor 2016. Kjo listë është edhe më interesante, pasi aty gjenden emra të cilët kryesojnë listën e deputetëve aktiv në seancat plenare, por që mbeten inaktivë në komisionet parlamentare. Kemi të bëjmë me çështje të imazhit, rendje pas lajmit në media, problem audience, apo deficit në aftësinë parlamentare për të prodhuar ligje dhe ekspertizë? Të gjitha ose disa, por në thelb, në

EMRI DHE MBIEMRI	PARTI	DISK. KOMISION	EMRI DHE MBIEMRI	PARTI	DISK. KOMISION
AGRON ÇELA	LSI	0%	KEJDI MEHMETAJ	LSI	0%
ANDUEL XHINDI	PS	0%	LUAN DUZHA	LSI	0%
AQIF RAKIPI	PDIU	0%	LUAN RAMA	LSI	0%
ARBEN IMAMI	PD	0%	LULJETA ARAPI	PS	0%
ARMANDO PRENGA	PS	0%	MHILL FUFI	PA PARTI	0%
ASTRIT PATOZI	PD	0%	MIRELA FERRACAKU	PKD	0%
BASHKIM FINO	PS	0%	MONIKA KRYEMADHI	LSI	0%
BEN BLUSHI	LIBRA	0%	OLTA XHAÇKA	PS	0%
DASHAMIR KAMBERI	PS	0%	PARID CARA	PS	0%
EDI PALOKA	PD	0%	PIRO KAPURANI	LSI	0%
ENKELEJDA SHKRELI	PS	0%	SADRI ABAZI	PS	0%
ESMERALDA SHKJAU	PS	0%	SHKËLQIM SELAMI	LSI	0%
GJOVALIN BZHETA	PD	0%	SHKËLQIM TROPLINI	PS	0%
GRAMOZ RUÇI	PS	0%	SHPËTIM IDRIZI	PDIU	0%
ILIR PENDAVINJI	PS	0%	TOM DOSHI	PS	0%

Monitorimi i Kuvendit: shtator-dhjetor 2016. Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al)

praktikat parlamentare angazhimi në komisione është më i rëndësishëm sesa angazhimi në seancat plenare.

INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES

www.isp.com.al

Në Shqipëri, për shkak të modelit të “media-demokracisë” debatet në seancat plenare janë lajmi kryesor politik i javës, vetë komisionet prodhojnë lajme vetëm kur ka zhvillime negative brenda tyre (incidente, hetime, akuza, etj).

Siç shihet në këtë listë bëjnë pjesë deputetët e njohur të parlamentit, Patozi, Blushi, Imami, Paloka, Ruci, Kryemadhi, Rama, Mehmetaj, etj. Pranë tyre ndodhen edhe deputetët e përhershëm “të heshtur”, prurjet aksidentale nga bota e biznesit apo lidhje të tjera jashtë praktikave të karrierës normale demokratike në një parti dhe në një proces serioz zgjedhor.

GRATË DEPUTETE: ATO MË ME SHUMË DHE ATO QË KANË “HESHTUR”

Referuar diskutimeve mbi bazë gjinore, rezulton se gratë deputetë vijojnë të jenë në përqindje të lartë shumë aktive në debatet parlamentare dhe në mbledhjen e komisioneve të ndryshme parlamentare.

Sipas renditjes edhe gjatë sesionit të dytë 2016 (shtator-dhjetor) në krye të listës për diskutime parlamentare nga ana e grave deputete, është Jozefina Topalli me 10 diskutime.

Ajo ndiqet nga dy deputetet e PD, Tabaku dhe Vokshi, me nga 9 dhe 8 diskutime, Doda, Hafizi e Cupi me nga 7 diskutime, Deda e Hajdarmataj me nga 6 diskutime, Halimi dhe Kopliku me nga 5 diskutime, etj. Interesant është fakti se edhe te gratë deputete përfaqësueset e PD janë dukshëm dominuese ndaj diskutimeve që vijnë nga gratë parlamentare të së majtës. Konkretisht, në listë Hysi e Spahiu janë deputetet socialiste më me shumë diskutime (4 diskutime) ose 31% efektivitet në raport me 10 diskutimet e Topallit.

Në fund të listës konstatohet se pesë gra deputete (Shkreli, Arapi e Shehu të PS, Kryemadhi e LSI dhe Ferracaku e PKD) nuk kanë folur në asnjë nga seancat parlamentare të sesionit të vjeshtës 2016.

DISKUTIME NGA DEPUTETE GRA & VAJZA NË SESIONIN SHTATOR-DHJETOR 2016					
JOZEFINA TOPALLI	PD	10	ANTONETA DHIMA	PS	4
JORIDA TABAKU	PD	9	EVIS KUSHI	PS	3
MIMOZA HAFIZI	LIBRA	8	BLERINA GJYLAMETI	PS	3
ALBANA VOKSHI	PD	8	EDLIRA CEKREZI	LSI	3
MESILA DODA	PDIU	7	ERJETA ALHYSA	PS	2
MIMOZA HAJDARMATA	PD	7	KEJDI MEHMETAJ	LSI	2
DHURATA CUPU	PD	7	OLTA XHACKA	PS	2
ALBINA DEDA	PD	6	ARTA DADE	PS	2
IRMA KOPLIKU	PD	5	ANILA AGALLIU	PS	2
ARBJOLA HALIMI	PS	5	ESMERALDA SHKJAU	PS	1
ELEINA QIRICI	PD	4	ADELINA RISTA	PS	1
KLODIANA SPAHIU	PS	4	ENKELEJDA SHKRELI	PS	0
LILJANA ELMAZI	PD	4	LULJETA ARAPI	PS	0
MAJLINDA BREGU	PD	4	MIRA SHEHU	PS	0
SILVA CAKA	LSI	4	MIRELA FERRACAKU	PKD	0
VASILIKA HYSI	PS	4	MONIKA KRYEMADHI	LSI	0

KOMISIONET PARLAMENTARE, - GJETJET KRYESORE

Bazuar në nenin 18 të Rregullores së Kuvendit, Komisionet e përhershme të Kuvendit shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta.

Kuvendi emëron në seancë plenare 8 komisione të përhershme, por mund të ngrejë në çdo kohë edhe komisione të posaçme parlamentare (komisione hetimore ose komisione ad-hoc), si dhe nën/komisione (brenda komisioneve).

4.1. Deputeti Berisha, i vetmi parlamentar pa anëtarësi në komision

Referuar rregullores, neni 19 “në komisionet e përhershme marrin pjesë të gjithë deputetët dhe përbërja e tyre, për aq sa është e mundur, pasqyron grupet parlamentare, sipas përpjesëtimit që zënë në Kuvend”. Të vetmit që nuk mund të jenë anëtarë të Komisioneve të përhershme janë Kryetari i Kuvendit dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave.

Referuar të dhënave të parlamentit aktual, përveç Ministrit Klosi, i cili sipas këtij neni, nuk mund të jetë anëtar i një komisioni specifik, ekziston edhe rasti i deputetit Berisha: ish kryeministri nuk figuron anëtar në asnjë prej komisioneve parlamentare, në kundërshtim me nenin 19, pjesa e dytë e tij, të rregullores.

4.2. Kryetarët e Komisioneve: protagonizëm politik më të madh sesa funksioni i tyre

Në zbatim të Rregullores (neni 23), kryetarët e komisioneve të përhershëm përfaqësojnë komisionin, organizojnë dhe drejtojnë mbledhjet e komisionit, mbajnë lidhje me organet e tjera, si dhe sigurojnë respektimin e procedurave.

Monitorim praktik i aktivitetit të komisioneve, sidomos debatit rreth ligjeve dhe debatit politik, nxjerr në pah krijimin e një modeli tjetër të kryetarëve të komisioneve, - nga rol koordinator dhe “speaker” i komisionit në drejtues absolut të tij.

Shumica e kryetarëve të Komisioneve komentojnë çdo diskutim dhe kthejnë përgjigje për çdo çështje që ngrihet nga deputetë të palës rivale politike, pa qenë të ngarkuar për një funksion të tillë ekstra dhe duke shfaqur dukshëm tendencën për protagonizëm politik.

Ekzistojnë raste të shumta kur p.sh, edhe në prani të anëtarëve të qeverisë ose të institucioneve të rëndësishme kushtetuese, përgjigjet për çështje kritike nuk vijnë nga i ftuari kompetent në komision, por nga kryetari i komisionit. Edhe në rastin kur drejtimi i përket opozitës, gjuha e drejtimit është larg asaj moderatore.

4.3. Bojkot i komisioneve: Shkelet rregullorja, asnjë masë nga Kuvendi

Sipas nenit 40 të Rregullores së Kuvendit “anëtarët e komisionit duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisionit. Kur një anëtar i tij mungon pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht gjatë një sesioni, komisioni mund të vendosë që kryetari i komisionit t’i kërkojë, në seancë plenare, grupit parlamentar përkatës zëvendësimin e anëtarit të komisionit”.

Ekipi monitorues i ISP konstatoi se janë një numër i madh anëtarësh të komisioneve të cilët nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje komisioni ose në shumicën e mbledhjeve të Komisionit. Konkretisht, gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016 nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje të komisionit përkatës parlamentar deputetët Luan Rama (LSI), Monika Kryemadhi (LSI), Gjovalin Bzheta (PD), Armando Prenga (PS) dhe Enkelejda Shkrelji (PS). Po ashtu me vetëm një prezencë në mbledhjet e komisioneve respektive janë edhe deputetët Shkelqim Selami (LSI), Arben Imami (PD), Edi Paloka (PD) Agron Çela (LSI) dhe Parid Cara (PS). Me vetëm dy prezencë në mbledhjet e komisioneve katër mujore janë tre deputetë të tjerë Topalli (PD), Shkijau (PS) dhe Xhakolli (PS).

Për disa prej deputetëve mund të ketë justifikime të përkohshme (fatkeqësi në familje, udhëtime, angazhime të tjera të rëndësishme, arsye shëndetësore, etj), por për shumicën e emrave të mësipërm, të përmendur të të dhënat e Institutit, nuk ka justifikim dhe se dukshëm kemi të bëjmë me mosrespektim të Rregullores së Kuvendit, neni 40.


4.4. Natyra e debatit: dominuese replikat dhe deklaratat politike

Në tërësinë e tyre, në komisionet e përhershme (me ndonjë përjashtim tek Komisioni për Integrimin Evropian, ku kryetare është deputetja Bregu, e cila nuk ka pozicion militant në partinë e saj), dominuese janë deklaratat politike, replikat personale, denigrimet ndaj tjetrit, kundërshtitë apriori, si dhe deklarime për konsum politik ditor. Janë të rralla rastet kur komisioni respekton thelbin e debatit mbi ligje të caktuara apo rend dite teknik dhe kur debati kryhet brenda normalitetit parlamentar.

Zbardhja e procesverbaleve, në disa prej komisioneve, nxjerr në pah mungesën e dukshme të etikës në komunikim, tendencën e deputetëve ekstremistë e militantë për të krijuar përplasje me palën tjetër dhe për të prodhuar lajm në media, si dhe ikjen nga argumentet dhe gjuha profesionale e debatit. Referimet në legjislacionin pozitiv të vendeve të tjera zënë vend minor, duke krijuar përshtypjen se cilësia e përgatitjes së parlamentarëve në tërësi është sipërfaqësore dhe jo profesionale.

5. AKTIVITETI I KOMISIONEVE TË PERHERSHME PARLAMENTARE

Statistikat e mbledhjeve të Komisioneve për Periudhën shtator-dhjetor 2016 tregojnë se numri më i madh i mbledhjeve është zhvilluar në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin për Ekonomi dhe Financë. Komisionet e tjera kanë numër deri në tre herë më të vogël mbledhjesh, një tregues i faktit se axhenda parlamentare dhe legislative ka qenë e vakët, dhe se ekzekutivi e vetë deputetët kanë shfaqur paaftësi në të drejtën e përgjegjësinë e tyre për të iniciuar ligje të reja, për përmirësime ligjore ose për të konsumuar elementë të tjerë të natyrës parlamentare.



Nga ana tjetër, fakti se dy komisionet kanë pasur më shumë aktivitet, përbën meritë të tyre dhe aftësi për të kërkuar tematika dhe për të ushtruar në maksimum kompetencat e tyre ndaj akteve parlamentare, ndaj institucioneve partnere të fushës dhe për rritjen e dimensionit ligjvënës të deputetëve anëtarë dhe të vetë institucionit.

Të dhënat mbi angazhimin e deputetëve në debatet në komision tregojnë se përqindjen më të lartë të mungesës së produktivitetit (pjesëmarrjes në debate të anëtarëve të komisionit) e ka komisioni i Integritimit me rreth 60%.

Në vend të dytë të vlerësimit negativ ndodhet komisioni i Sigurisë Kombëtare me 44% mungesë efektiviteti, ku 8 nga 18 anëtarë nuk kanë marrë pjesë aktive në asnjë nga debatet e komisionit. Në

vendin e tretë negativ ndodhet komisioni i politikës së jashtme, ndjekur nga komisioni i punës, çështjeve sociale e shëndetësisë, nga komisioni i ligjeve dhe ai i veprimtarive prodhuese.

KOMISIONET	DISKUTIME	NUK FOLEN	ANETARE	PRODUKTIVITETI
<u>Kom. Integrimi Evropian</u>	6	6	10	60%
<u>Kom. Politika e Jashtme</u>	26	4	12	33%
<u>Kom. Shendetesi & Sociale</u>	78	4	16	25%
<u>Kom. Medias dhe Edukimit</u>	67	5	17	29%
<u>Kom. i Sigurise Kombetare</u>	31	8	18	44%
<u>Kom. Ekonomi & Finance</u>	125	1	21	5%
<u>Kom. Veprimtarise Prodhuese</u>	198	3	22	14%
<u>Kom. Ligje & Administrate</u>	82	5	24	21%

Komisioni me efektivitetin më të lartë pozitiv është ai i ekonomisë dhe financës, me numrin më të lartë të deputetëve të angazhuar në debatet e tij, - vetëm 1 deputet nuk është angazhuar dhe nuk ka marrë pjesë në debat.

6. AKTIVITETI I NËN/KOMISIONEVE TË PERHERSHME PARLAMENTARE

Referuar të dhënave të vetë parlamentit, të tri nënkomisionet parlamentare nuk kanë arritur të kenë aktivitet solid dhe permanent. Konkretisht, nën/komisioni për të drejtat e njeriut nuk është mbledhur asnjëherë gjatë vitit 2016.

Mbledhjet e fundit të tij (gjithsej 4) datojnë në vitet 2013-2014. Nën/komisioni për qeverisjen vendore gjithashtu nuk ka pasur mbledhje as më 2016. Nën/komisioni për barazi gjinore dhe të miturit ka zhvilluar vetëm dy mbledhje gjatë viteve 2015-2016, por asnjë gjatë sesionit parlamentar të vjeshtës.

N/kom. Te drejtat e Njeriut	4	2013-2014
N/kom. Qeverisjen vendore	0	2015-2016
N/kom. Barazi Gjinore & Mitur	2	2015-2016

Të dhënat vijnë në kontrast të thellë me problematikat e shumta që ka pasur këto vite, përfshirë gjysmën e dytë të vitit 2016, ne fushën e të drejtave të njeriut, të dhunës në familje, të shkeljes së të drejtave të grave, të dhunës e krimeve ndaj të miturve, si dhe problematikën vendore.

7. AKTIVITETI I KOMISIONEVE TË POSACME PARLAMENTARE

Komisionet e Posaçme parlamentare kanë një rol specifik, sidomos në ushtrimin e kompetencës së parlamentit për hetimin e skandaleve dhe çështjeve të rëndësishme me interes publik, dhe në funksionin e opozitës parlamentare për të kontrolluar qeverisjen.

Të dhënat e parlamentit aktual gjatë katër viteve të fundit, tregojnë se komisionet e posaçme kanë qenë më shumë nisma politike për momente të caktuara me përfitim politik sesa nisma institucionale me impakt publik dhe institucional, - për përmirësimin e cilësisë së shtetit dhe të qeverisjes në vend.

Referuar të dhënave gjatë vitit 2016 kemi pasur tri komisione të posaçme, - Komisioni për Reformën zgjedhore i cili brenda një viti zhvilloi vetëm 2 mbledhje, Komisioni për hetimin e problematikave të CEZ/KESH, i cili zhvilloi 13 mbledhje gjatë 2016, si dhe Komisioni i hetimit mbi skandalin e përgjimeve, i cili zhvilloi 3 mbledhje.

Në total janë numër minimal komisionesh, dhe sidomos, numër minimal mbledhjesh, - një tregues i dobësisë së parlamentit dhe të grupeve parlamentare për ushtrimin e drejtë të funksionimit përmes komisioneve hetimore të posaçme.

KOMISIONET E POSACME	MBLEDHJE	VITI
<u>Kom. Mbi Dekriminalizimin</u>	10	2015
<u>Kom. Ref.Administrative</u>	15	2014
<u>Kom. Mbi Policine e Shtetit</u>	12	2014
<u>Kom. Mbi Forcat e Armatosura</u>	3	2014
<u>Kom. Mbi 2 anetare te KLD</u>	5	2014
<u>Kom. Sis. elektronik i Tatimeve</u>	17	2015
<u>Kom. Mbi Pergjimin</u>	3	2016
<u>Kom. Reforme Zgjedhore</u>	2	2016
<u>Kom. Mbi CEZ & KESH</u>	13	2016
<u>Kom. Emerimeve Administrate</u>	10	2015


6.1. KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Një nga funksionet më të rëndësishme të Kuvendit është shqyrtimi dhe miratimi i ligjeve. Parlamenti ynë funksionon me skemën klasike, - mbledhje në komisione dhe më pas, seancë plenare gjatë ditës së enjte. Komisioni kryesor në parlament është Komisioni i Ligjeve, ose siç zyrtarisht cilësohet “Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”.

Referuar të dhënave krahasuese të periudhës shtator-dhjetor 2016, - periudhë intensive për reformën në drejtësi, reformën zgjedhore, zgjedhjet në KQZ dhe shqyrtimin e miratimit të Buxhetit të Shtetit, - Komisioni ka zhvilluar rreth 23 mbledhje pune nga 53 mbledhje të zhvilluara gjatë sesionit tjetër janar – korrik 2016.

Komisioni i Ligjeve kryeson me numrin e mbledhjeve në raport me komisionet e tjera, dhe gjithashtu, dukshëm është komisioni më me shumë propozime për amendime e korrektive ligjore në Kuvend. Megjithatë, suksesi i tij në raport me komisionet e tjera, mund të vijë edhe për shkak të dobësisë së punës të komisioneve të tjera, apo çështjeve të cilësisë së përfaqësimit. Ndaj një analizë më e detajuar e mbledhjeve të këtij komisioni japin të dhëna interesante.

Në 23 seanca të Komisionit të Ligjeve janë shënuar 82 diskutime, në raport 3.4 diskutime për mbledhje komisioni. Kjo është një përqindje mjaft e vogël referuar rëndësisë së ka komisioni i ligjeve dhe nevojës së madhe për ekspertizë të thelluar ligjore. Në praktikën e parlamenteve perëndimore komisione të tilla kanë nivele deri 5 herë më të larta debati dhe të pjesëmarrjes aktive. Pavarësisht se raporti 3.4 diskutime në mbledhje komisioni, shqetësimi kryesor nuk qëndron këtu, por tek të dhënat e diskutimeve dhe përqendrimi konkret i tyre.




Mbledhjet e Komisionit të Ligjeve janë drejtuar gjithnjë nga kryetari Fatmit Xhafaj, i cili, përvec drejtimit, ka bërë vazhdimisht ndërhyrje në çështje konkrete të ligjeve, debatit dhe ka bërë amendime/propozime, etj. Si kryetar, Xhafaj nuk mund të jetë objekt i klasifikimit të numrit të diskutimeve në komisione. Ndaj me këtë kriter, numrin më të lartë të ndërhyrjeve e ka deputetja Vasilika Hysi, me diskutime në 16 nga 23 mbledhjet e Komisionit. Ajo ka dyfish më shumë diskutime në seancat e komisionit sesa dy deputetët e tjerë më aktivë në Komision, Eduart Halimi (PD) dhe Ulsi Manja (PS). Pas tyre, në vendin e katërt më me shumë diskutime vijjnë Dashamir Peza, Petrit Vasili dhe Anila Agalliu.


Dy politikanët opozitarë, Bylykbashki e Ristani kanë numër të njëjtë të ndërhyrjeve, po aq sa deputeti i ri i sesionit të pranverës, Edmond Leka. Deputetët e tjerë kanë raste minimale ndërhyrjesh, madje tre deputetë (njëri prej tyre është zëvendësues në mbledhjet e këtij komisioni) nuk kanë diskutuar asnjëherë. Shprehja, - ka deputetë që marrin pjesë në komision vetëm për të regjistruar emrin dhe përfituar pagesën, - vlen dukshëm në këtë rast.

Referuar datave të mbledhjeve të Komisionit dhe diskutimeve të zhvilluara në to, rezulton se mbledhjet më me interes debati nuk janë ato që lidhen me ligje të rëndësishme, por rastet kur palët kanë interesa direkte politike. Të tilla janë debatet për selektimin e kandidatëve për kryetar në KQZ, debati mbi trafikun e drogës, gjendjen e sigurisë, debati mbi komisionin për hapjen e dosjeve, etj.

Siç shihet nga tabela vetëm në 6 mbledhje ka pasur më shumë se gjashtë deputetë të përfshirë në debat, kurse në mbledhjet e tjera, numri i deputetëve të përfshirë ka qenë simbolik, - kryesisht deputeti që duhet të jetë relator dhe ndonjë tjetër me ndërhyrje apo pyetje.



PJESEMARRJA NE KOMISIONIN E LIGJEVE



Një tregues interesant është edhe pjesëmarrja e deputetëve në mbledhjet e Komisionit. Praktika parlamentare përcakton përbërjen fikse dhe disa deputetë zëvendësues, të cilët përdoren sidomos kur pala politike ka interes për vendimmarrje/debat politik. Dy anëtarë të Komisionit nuk kanë qenë asnjëherë të pranishëm, një për arsye shëndetësore (BF) dhe një tjetër për arsye të tjera (TD).

Megjithatë shihet nga tabela se tetë deputetët e parë me numrin më të lartë të pjesëmarrjes në komision janë deputetë të mazhorancës, pra të shumicës qeverisëse. Opozita ka përfaqësim mesatar, madje dy nga kryetarët e partive opozitare pjesëmarrës në Komision kanë shifra minimale prezence dhe akoma më minimale ndërhyrjesh/debati. Mjafton kjo tabelë për të kuptuar se përfaqësimi i deputetëve në Komision është dukshëm nën nivelin e një standardi të lartë parlamentar, dhe se referuar opozitës, është dukshëm nën standardet që ajo promovon.


Gjatë periudhës shtator – dhjetor 2016 rezultoi se kanë qenë prezent në Komision disa prej anëtarëve të kabinetit qeveritar (Manjani, Harito, etj, zv/ministra dhe drejtues të gjyqësorit dhe të organeve kushtetuese. Duke pasur rëndësinë e Komisionit dhe krye-temën e reformës në drejtësi, do të kishte qenë e pritshme një përfaqësim më i lartë i zyrtarëve të niveleve kushtetuese në këtë komision, si dhe një proces shumë më angazhues i komisionit dhe i parlamentit për promovimin e axhendës, aktivitetit, pritshmërive dhe kapaciteteve reale & sfidave të tij.

Duket theksuar se disa prej anëtarëve të këtij komisioni kanë qenë njëherësh edhe anëtarë në Komisione të tjera parlamentare (sidomos Komisioni për Reformën në Drejtësi) dhe se aktiviteti

i tyre në komision zë vetëm një prej disa funksioneve e detyrimeve që ata kanë në kuadrin parlamentar. Ky faktor ka ndikuar indirekt edhe në produktivitetin e Komisionit dhe në problematikat e përmendura më lart.

8.1. KOMISIONI I SIGURISË KOMBËTARE

Për shkak se tema e “dekriminalizimit”, “trafikut”, “kanabis” etj, ka qenë temë dominuese në ligjërimin politik gjatë vitit të fundit, edhe Komisioni i Sigurisë Kombëtare në parlament, ka pasur dhe ka rol e vëmendje specifike.




Një pjesë e deputetëve të këtij Komisioni janë figura politike (dy ish ministra të brendshëm), një pjesë kanë karrierë të mëparshme policore e ushtarake, por nga ana tjetër, aty ka deputetë që kanë bërë headline me skandale publike e incidente, siç ka deputetë të përfolur në raporte ndërkombëtare e në media për të shkuar kriminale. Një deputet që ka dhënë dorëheqje, një që është në proces gjykimi dhe një tjetër i larguar së fundmi, ishin anëtar i këtij Komisioni. Ironia është se për një vend të NATO-s, Komisioni i Sigurisë do të duhej të ishte Komisioni më me besueshmëri tek partnerët ndërkombëtarë, - standard që dukshëm nuk është përmbushur.

Analiza monitoruese jep detaje të dy elementëve të aktivitetit të këtij Komisioni gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016. Së pari, mbi tematikën e punës, së dyti mbi pjesëmarrjen e deputetëve në komision dhe në debatet e brendshme.

Gjatë kësaj periudhe parlamentare në Komision u paraqitën ministrat Tahiri dhe Kodheli, zv/ministrat përkatës të tyre, si dhe drejtues të tjerë të institucioneve të sigurisë. Temë kryesor e debateve në komision ishin çështjet e buxhetit në FA dhe Ministrinë e Brendshme, si dhe çështje të karakterit përmirësues të disa ligjeve dhe akteve të tjera që lidhen me sigurinë. Në Komision nuk ka pasur séance të jashtëzakonshme dhe as organizime të brendshme për misione monitoruese në institucionet e sigurisë.

Sipas praktikës parlamentare, Komisioni i Sigurisë përbëhet nga 18 anëtarë të përhershëm dhe disa deputetë zëvendësues. Në asnjë nga mbledhjet e Komisionit gjatë periudhës shtator – dhjetor 2016 nuk kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit.

Gjatë kësaj periudhe Komisioni ka zhvilluar vetëm 8 mbledhje të rregullta, në të cilat, përveç kryetarit Braho, ka marrë pjesë rregullisht vetëm deputeti Lutaj. Deputeti Rama figuron mospjesëmarrjes në asnjë mbledhje, ashtu si edhe deputeti Prenga (nën hetim gjyqësor), por numër minimal pjesëmarrjeje kanë edhe disa deputetë përfshirë edhe deputetin Selami, të larguar disa ditë më parë nga KQZ.




Në listën e deputetëve diskutues ka të dhëna interesante: dy deputetët opozitarë Noka e Dogjani, ashtu si Lutaj i PS, kanë nivel të njëjtë pjesëmarrjeje në debatet në Komision. Në total, ata kanë shumë më tepër diskutime sesa të gjithë deputetët e tjerë, anëtarë të Komisionit. Pjesë në debate janë edhe deputetët me karrierë në polici dhe organe të sigurisë, Ndreu, Çuko, Zeneli, Qefalia, - këta të fundit, me përqindje pjesëmarrjeje në debat rreth 20-25%.

Pjesa më interesante është numri i madh i deputetëve që nuk kanë folur asnjëherë në Komisionin e Sigurisë. Lista është e gjatë, rreth 40% ose tetë deputetë, nga të cilët, dy nuk kanë qenë asnjëherë të pranishëm në mbledhje. Nga deputetët që kanë marrë pjesë në disa mbledhje Komisioni por nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në diskutimet e ligjeve dhe akteve të tjera, janë emra si Rakipi PDIU, Troplini (PS), Patozi (PD), Xhindi (PS), Shehu (LSI) e Selami (LSI).

Në krahasimin e numrit të deputetëve që kanë folur dhe atyre që nuk kanë folur (por kanë marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit), të dhënat tregojnë se pjesa e “të heshturve” është 3-4 herë më i madh sesa pjesa e atyre që flasin. Vetëm në një seancë, 22 nëntor, ka ndodhur që midis 12 pjesëmarrësve në mbledhje kanë folur 6 deputetë, siç ka raste, si seanca e fundit me 5 dhjetor, kur nga 15 deputetë të pranishëm, përveç kryetarit, kanë folur vetëm 4 deputetë.

8.2. Komisioni i Integritit Evropian dhe Komisioni i Politikës së Jashtme


Komisioni i Integritit Evropian dhe Komisioni i Politikës së Jashtme në parlament janë komisione me fokus të përafërt pune, dhe me vlerë në procesin e përafrimit drejt BE. Komisioni i Integritit mbetet specifik, për shkak se në të bëjnë pjesë dy kryetarët e grupeve kryesore parlamentare, Ruçi e Paloka, dhe se kryetari është nga opozita (Bregu). Tek Komisioni i Politikës së Jashtme, bëjnë pjesë disa ish ministra (Dade, Bumçi, Blushi, Leskaj, Islami, si dhe ish kryetarët e parlamentit Topalli e Dokle). Monitorimi i aktivitetit të tij nga Instituti i Studimeve Politike ofron të dhëna interesante.



Gjatë sesionit parlamentar të vjeshtës këto komisione kanë pasur një numër minimal mbledhjesh: 4 mbledhje komisioni për integrimin dhe dy herë më shumë, 8 mbledhje, komisioni i jashtëm. Tematika e mbledhjeve është e kushtëzuar nga praktika rutinë të punës, – kryesisht kalim teknik të ligjeve që lidhen me komisionet, raport progresi i BE, çështjet e buxhetit në sektorët që mbulojnë, si dhe seancat për problematika të veçanta të ambasadorëve dhe MPJ.

Komisioni i Integritit ka seanca të shkurtra mbledhjeje, dhe vetëm në një rast ka më shumë se dy diskutues. Pra, janë më shumë mbledhje formale rutinore sesa debate e diskutime të standardit të lartë, në përputhje me pritshmërinë publike që ka ky komision.

PJESEMARRJE & DISKUTIME KOMISIONI I POLITIKES SE JASHTME




Ajo që bie dukshëm në sy në të dhënat monitoruese të këtyre komisioneve është fakti se figurat kryesore politike që bëjnë pjesë në to, nuk janë angazhuar dhe thuajse nuk kanë pasur asnjë rast të vetëm të ndërhyrjeve në formë komenti, diskutimi apo amendimi. Tek Integrimi nuk kanë folur asnjëherë asnjëri nga kryetarët e dy grupeve kryesore parlamentare, Ruci e Paloka, madje numri i deputetëve që nuk kanë folur asnjëherë është dukshëm më i lartë sesa numri i atyre që kanë folur (në raportet 6 me 4).

Tek komisioni i jashtëm nuk kanë marrë folur asnjëherë figura të njohura politike si Topalli, Idrizi dhe Blushi, ndërkohë që deputetët më me shumë angazhim përveç kryetares, kanë qenë Islami e Bumçi. Fakti se deputetët më të heshtur të këtij komisioni bëjnë pjesë në listën e deputetëve më aktiv në diskutimet në seancat plenare në Kuvend, do të thotë se aktiviteti në Komision nuk merr rëndësinë e duhur dhe nuk përbën një tribunë promovimi të politikës dhe politikanëve me ambicie publike.

Një element tjetër tipizues në punën e këtyre dy komisioneve është fakti se tek Integrimi nuk ka konflikt politik dhe debatet janë kryesisht për çështje të rëndit të ditës, kurse tek Komisioni i Jashtëm shpeshherë ka debate e replika politike, jashtë rendit të ditës ose të prirura nga axhenda politike. Axhenda e komisionit, sipas rutinës edhe të komisioneve të tjera parlamentare, është e diktuar nga rendi i ditës në procedurën e ligjeve, dhe mungojnë, si kudo, nismat specifike të komisionit për trajtime të thelluara të problematikave të sektorit.

8.3. Komisioni për Financë dhe Ekonomi

Çdo ligj që kalon në parlament shoqërohet me kosto financiare dhe për më tepër, ecuria e procesit të reformave ka të bëjë kryesisht me gjendjen & evoluimin financiar të vendit. Për këtë arsye Komisioni i Ekonomisë dhe Financave në Kuvend mbetet komisioni i dytë më i rëndësishëm pas Komisionit të Ligjeve. Sipas treguesve të monitorimit nga Instituti i Studimeve Politike, numri i madh i mbledhjeve të zhvilluara nga ky Komision përgjatë periudhës shtator-dhjetor 2016 është tregues edhe i intensitetit të punës së tij. Në Komision marrin pjesë edhe disa ministra financave (Bode, Angjeli, Cani, Mima) disa ish ministra në sektorë të tjerë (Spaho, Shehi), si dhe deputetë me karrierë në administratë e shërbimet publike.



Ndryshe nga Komisionet e tjera, në këtë komision ka pasur prani më të shpeshtë të ministrave, sidomos të Ministrit të Financave Ahmetaj. Nga ana tjetër, në komision janë paraqitur shumica e institucioneve kryesore (për shkak të projekt buxhetit të shtetit), si dhe ka pasur raportime edhe nga institucione të rëndësishme në natyrës financiare, si Guvernatori i Bankës apo Kryetari i KLSH.

Tregues interesant i këtij komisioni është numri i madh i deputetëve të përfshirë të debate dhe kontinuiteti i ndërhyrjeve të tyre. Nga mazhoranca më aktivët kanë qenë Braçe, Angjeli, Koçi, Cani, Bushati, kurse nga opozita në krye të listës janë Bode, Mima, Cara dhe Spaho. Është interesante fakti se ish ministri Bode ka diskutuar në të gjitha seancat ku ka qenë i pranishëm, siç rekord negativ mban deputeti Luzha (LSI), i cili nuk ka diskutuar në asnjë nga 23 mbledhjet e komisionit. Braçe, Bushati e Marto janë të vetmit deputetë që nuk kanë munguar në asnjë mbledhje, kurse, në krahasim me

komisionet e tjera, numri i deputetëve me pjesëmarrje minimale në mbledhjet e Komisionit është gjithashtu minimal, vetëm 1 deputet (Luzha).

Në të dhënat përmbajtësore të aktivitetit të këtij Komisioni bien dukshëm në sy tri tipare:

- së pari, pesha e akteve ligjore dhe ekonomike është shumë më e madhe sesa vendi që zënë aktet politike por argumentet politike mbeten dominuese;
- e dyta, numri i zyrtarëve të lartë të thirrur në komision është më e larmishme dhe në nivel më të lartë se shumica e komisioneve të tjera;
- e treta, është ndër komisionet më me shumë replika midis kryetarit të komisionit dhe anëtarëve (të opozitës). Ka raste të shumta kur anëtarët e komisionit nuk i drejtohen njëri tjetrit me cilësinë e partnerit përballë të ftuarit në komision, por me cilësinë e kundërshtarit politik, - një tregues që nuk është tipar i komisioneve të njëjta në shumicën absolute të vendeve demokratike në kontinent.

Së fundi, debatet në komision, edhe për shkak të pjesëmarrjes së një numri të lartë anëtarësh të komisionit, kanë prodhuar një arkiv të pasur me të dhëna ekonomike e financiare, të cilat, edhe nëse duhen marrë me rezervë në vërtetësinë e tyre, ofrojnë një pamje të përgjithshme të ekonomisë dhe financave në vend, - një tregues që rrallë e gjen tek pjesa më e madhe e komisioneve të tjera parlamentare.

8.3.1. Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin


Ky komision ka pak njohje në publik, por gjatë sesionit të vjeshtës shtator-dhjetor 2016 mori vëmendje të madhe për shkak të rikthimit në axhendë të ligjit të mbetjeve. Pjesë e Komisionit janë ish ministrat e bujqësisë Duka e Ruli, ish sekretari i shtetit Baraj, si dhe një numër i madh figurash protagoniste politike, përfshirë deputetin e larguar D.Tahiri dhe deputetin E.Ndocaj.

Referuar të dhënave krahasuese ky komision ka një numër rekord mbledhjesh (28) dhe për më të tepër, numër rekord diskutimesh (198). Kjo shifër rekord krahasuar me komisionet e tjera (p.sh, gjashtë herë më shumë diskutime se Komisioni për Sigurinë, apo rreth 2.5 herë më shumë se Komisioni i Ligjeve), lidhet edhe me diapazonin e gjerë të çështjeve që mbulon (bujqësia, turizmi, industria, territori, mjedisi, etj). Të gjithë ministrat që mbulojnë këta sektorë kanë qenë të pranishëm në Komision, duke pasur gjithashtu shifër rekord të pjesëmarrjes së tyre. Gjithashtu kanë qenë të pranishëm edhe një numër institucionesh të sektorëve në këto problematika.

Të dhënat tregojnë se deputeti N.Kopliku ka marrë pjesë në secilën nga mbledhjet e Komisionit, ndjekur nga deputetët G.Ruli, B.Baraj dhe I.Kopliku. Nga ana tjetër, deputetja e LSI Monika Kryemadhi nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje Komisioni, kurse deputeti Cara ka vetëm 1 pjesëmarrje me mungesë të gjatë kryesisht për shkaqe të justifikuara personale. Edhe deputeti Ndocaj ka pjesëmarrje të ulët se bashku me deputetin Kosta, të dy të PS-së.

PJESEMARRJA DHE DISKUTIMET NE KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

■ Diskutime ■ Pjesemarrje




Ky komision është unikël në faktin se ka numrin më të lartë të mbledhjeve ku në mungesë të kryetarit drejton zv/kryetari (nga partia rivale politike), dhe se dominohet nga diskutime kryesisht teknike. Elementët dhe retorika politike shfaqen kryesisht në drejtimin e tij dhe në rastet e axhendave që kanë impakt publik.

Në Komision, me cilësinë e anëtarëve zëvendësues, kanë marrë pjesë edhe deputetë të tjerë, Hafizi, Toci, Derveni, Kamberi, Bejko, dhe kanë folur në rastet e pjesëmarrjes së posaçme. Kurse nga anëtarët e përhershëm, më shumë diskutime, përveç dy drejtuesve Shalsi e Ruli, kanë deputetët Kopliku e Baraj (PS), Bitri (LSI) si dhe Papa, Dashi, Bushati e Hajdarmataj (PD). Ndocaj, Duka e Gaçi kanë të njëjtin numër diskutimesh në komision, dy herë më pak se deputeti Suli.

Së fundi, me gjithë bilancin pozitiv në rekordin e mbledhjeve dhe diskutimeve, ky komision pikën më të dobët ka debatit për ligjin e njohur, si ligji i importit të plehrave, për shkak të menaxhimit formal dhe partiak të debatit, faktit se shumica e deputetëve ndryshuan qëndrimin e shprehur në komision, pasi çështja u bë pjesë e protestave dhe debatit publik dhe gjithashtu faktit se Komisioni e trajtoi këtë çështje më shumë në aspektin politik sesa teknik.

8.3.2. Komisioni i Punës, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka disa veçori që e dallojnë nga komisionet e tjera parlamentare: është komisioni i vetëm që drejtohet nga dy deputete gra, Vokshi (PD) dhe Spahia (PS), ka numrin më të lartë të grave deputete në përbërje (8 nga 16 deputetë), si dhe janë anëtare aty kryetarët e organizatave më të mëdha të grave politike në Shqipëri, kryetarja e forumit të grave në PS (Xhaçka) dhe në PD (Vokshi).



Në të dhënat monitoruese të Institutit të Studimeve Politike për periudhën shtator-dhjetor 2016 këta tre faktorë duket se nuk kanë arritur të bëjnë diferencën përmbajtjesore midis këtij komisioni dhe komisioneve të tjera parlamentare. Në Komision ka pasur prani disa herë të ministrit të shëndetësisë, ka qenë ministri i punës si dhe një numër i madh zyrtarësh që mbulojnë çështjet sociale e shëndetësore në vend. Krahasuar me komisionet e tjera ky komision ka pasur prani të lartë edhe të grupeve të interesit, sidomos në debatet për ligje të veçanta që lidhen me to.

Gjithsesi, të dhënat cilësore të debatit të zhvilluar në Komision rezulton se dominuese është retorika politike dhe mos-rakordimi midis dy drejtuesve kryesore të komisionit. Në të dhënat sasiore, rezulton se një e katërta e komisionit nuk ka folur në asnjë nga 14 mbledhjet e Komisionit (përkatësisht, Xhaçka e Pendavinji (PS), Tavo (LSI) dhe Ferracaku (PKD)). Vetëm në një rast ka diskutuar edhe drejtuesve e PDIU, Doda.

Nga ana tjetër, diskutuesit dominues në mbledhjet e Komisionit janë përveç drejtuesve kryesore Vokshi e Spahiu, edhe deputetet Halimi e Deda (PD), si dhe Alhysa (PS). Rol aktiv në debate kanë pasur edhe deputetet mjekë Keta e Mihaj (PD), si dhe Bejko (PS). Vlen të theksohet se me cilësinë e anëtares zëvendësuese, deputetja A.Rista ka marrë pjesë në katër mbledhje, me po kaq diskutime.

Në pjesëmarrjen në komision është interesant fakti se të paktën 7 deputetë kanë pasur 100% pjesëmarrje, duke vendosur rekord pjesëmarrja në raport me komisionet e tjera. Për më tepër, në 7 raste të tjera pjesëmarrja është 90%, gjithashtu tregues dominues. Dy deputetët më me pak pjesëmarrje i përkasin qarkut Korçë dhe kanë nivel 50% pjesëmarrje, pra shumë të lartë në krahasim me komisionet e tjera.


8.3.3. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Komisioni i Medias në Kuvend, i njohur si “Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik” është një nga dy komisionet parlamentare që drejtohet nga opozita.

Sipas raportit monitorues gjatë sesionit parlamentar shtator-dhjetor 2016 ka zhvilluar 9 mbledhje, me 67 diskutime deputetësh, megjithatë, një e treta e deputetëve të komisionit nuk kanë folur asnjëherë. Ky komision ka në përbërjen e tij disa tre ish ministra (Ulqini, Pollo, Tafaj), disa botues e biznesmenë edhe në fushën e medias e arsimit, të paktën një sportist dhe disa figura të njohura publike e mediatike. Kjo përbërje krijon pritshmërinë e cilësisë së lartë në debate dhe axhendë, - gjë që nuk gjen përputhje të plotë me rezultatet konkrete të konstatuara në monitorim.

Gjatë sesionit të vjeshtës temë kryesore e debatit publik kanë qenë çështjet e arsimit (regjistrimi në universitete) dhe çështjet e medias (disa incidente në media dhe raportet kritike për lirinë e medias në vend). Këto tema kanë zënë vend pjesërisht në komision, sidomos çështja e arsimit, por dominuese dhe më me interes për deputetët kanë qenë debatet lidhur me sportin, investimet shtetërore mbi to, federatat sportive etj. Kultura dhe problematikat mbi të zënë rol minor. Në Komision kanë qenë të pranishëm ministria e Arsimit dhe Kulturës, dhe një numër zyrtarësh të lartë të MAS, siç edhe drejtues të institucioneve të sporteve, kulturës dhe të medias publike, kryesisht në debate që lidhen me çështjet e buxhetit dhe dokumenteve të tyre të brendshme rregullatore.

PJESEMARRJA DHE DISKUTIMET NE KOMISIONIN E EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK



Në të dhënat teknike rezulton se tre deputetë, kryetari Pollo, zv/kryetari Peza dhe deputeti Hoxha kanë rekord pjesëmarrjeje dhe diskutimesh në mbledhjet përkatëse të komisionit. Në deputetët e tjerë diskutues më aktivët rezultojnë Toçi, Tafaj, Boçi dhe Rista, - deputeti Ylli është debatues në çështjet e sportit, Hafizi në të arsimin, etj. Dy deputetë (Bzheta PD dhe Shkrelli PS) nuk kanë marrë pjesë në asnjë prej mbledhjeve të Komisionit dhe natyrisht nuk kanë diskutime, kurse dy deputetë tre tjerë (Mehmetaj, Kamberi e Çela) kanë pjesëmarrje minimale dhe nuk kanë diskutuar asnjëherë.

Një nga treguesit pozitiv të këtij komisioni është tematika e gjerë e debatit dhe sidomos seancat e gjata të debatit me grupet e interesit (sidomos në fushën e sportit), kurse një nga treguesit kritikë të këtij Komisioni është axhenda pasive, - ecja sipas kalendarit të ligjeve pa nisma për seanca dëgjimore dhe trajtime të thelluara të problematikave, si dhe natyra partiake e diskutimit në rastin e temave të nxehta me interes publik. Disa përpjekje për seanca dëgjimore në raste të skandaleve që lidhen me cenimin e lirisë së medias rezultuan të pasuksesshme për shkak të mungesës së shumicës prezente dhe krijuan përshtypjen se interesat politike kanë shumë më tepër vlerë për Komisionin sesa interesat publike.